


Zyq Sholetj  
26.12.2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM



Nr. 839, datë 24.12.2019

PËR

**MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT,  
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QEVERISË SË MALIT  
TË ZI DHE KOMISIONIT EVROPIAN, PËR PROGRAMIN  
E VEPRIMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR IPA II,  
MALI I ZI – SHQIPËRI 2014-2020, ALOKIMET E VITIT 2018**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi – Shqipëri 2014-2020, alokimet e vitit 2018, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA